

Asistenca Financiare: Trinity Health angazhohet të ofrojë kujdes, trajtim dhe shërbime ndaj të gjithë atyre që vijnë tek ne për shkak të nevojave mjekësore.

Politika e Asistencës Financiare

- Ndihma financiare jepet në bazë të të ardhurave tuaja. Kjo përcaktohet duke përdorur [udhëzimet e Nivelit Federal për Varfërinë](#).
- Nëse fitoni [200]% ose më pak sipas udhëzimeve Federale për Nivelin e Varfërisë, mund të përfitoni një zbritje të plotë. Kjo vlen për shërbimet e nevojshme mjekësore.
- Nëse fitoni ndërmjet [201]% dhe [400]% të Nivelit Federal për Varfërinë, mund të përfitoni një zbritje të pjesshme.
- Trinity Health nuk do t'i tarifojë pacientët e kualifikuar më shumë se norma e zbritjes së Medicare.
- Mund të përfitojnë ulje sigurimet shëndetësore, bashkësigurimet dhe shpenzimet e zbritshme që ju keni. Ju mund të kualifikoheni për ndihmë nëse fitoni më pak se [400]% të Nivelit Federal për Varfërinë.
- Nëse jeni duke u përballur me kosto si pasojë e rrethanave të jashtëzakonshme, mund të përfitoni ulje. Kjo ndodh kur shpenzimet tuaja mjekësore për 12 muajt e fundit janë mbi 20% të të ardhurave tuaja të familjes. Ulja mund të përfshijë edhe siguracionet shëndetësore. Mund të përfshijë gjithashtu bashkësigurimin dhe shpenzimet e zbritshme.

Shqyrtoni Udhëzimet
Federale për Nivelin
e Varfërisë këtu



[Poverty Guidelines | ASPE
\(hhs.gov\)](#)

Shërbimet me zgjedhje të tilla si kirurgjia estetike nuk janë të përshtatshme për asistencë financiare.

Për të aplikuar për asistencë financiare, plotësoni dhe dorëzoni aplikimin. Politika e Asistencës Financiare të Trinity Health dhe Aplikimi janë të disponueshme në faqen e internetit të spitalit. [Financial Assistance | Trinity Health Michigan](#). Ju gjithashtu mund të kërkonte një kopje falas të politikës dhe aplikimit duke ardhur vetë, me postë ose duke telefonuar vendin ku keni marrë përkujdesjen ose duke kontaktuar Trinity Health Enterprise Patient Financial Services, 20555 Victor Parkway, Livonia, MI 48152, numër pa pagesë në 800-494-5797 .

Politika e Asistencës Financiare të Trinity Health, Aplikimi dhe Përmbledhja në Gjuhë të Thjeshtë janë përkthyer në gjuhë të tjera dhe ofrohen duke kontaktuar spitalin ose departamentin e Shërbimet Financiare për Pacientët ("Patient Financial Services") të listuara më sipër.

Lista e ofruesve të shërbimit: Lista e ofruesve të shërbimit që japin kujdes mjekësor urgjent ose kujdes të nevojshëm mjekësor në godinën spitalore, të cilët mbulohen nga Politika e Asistencës Financiare të spitalit, është në dispozicion në internet ose kur kërkohet.

Planet e pagesave afatshkurtra dhe afatgjata: Nëse nuk mund të paguani pjesën tuaj, mund të kualifikoheni për plane pagese afatshkurtra ose afatgjata. Plani i pagesës afatshkurtër i Trinity Health është pa interes. Pacientët duhet të paguajnë detyrimet e papaguara brenda një viti. Ju mund të përfitoni një plan afatgjatë me interes nëse nuk mund të paguani totalin e detyrimeve të papaguara brenda një viti.



Shërbimet financiare për pacientët: Këshilluesit financiarë janë në dispozicion për t'ju ndihmuar. Ata do t'ju ndihmojnë në plotësimin e aplikimit për asistencë financiare. Kjo do të përcaktojë se çfarë ndihme është në dispozicion. Kjo përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë për Medicaid.

Ju mund të kontaktoni një këshillues financiar në vendin ku merrni përkujdesje. Këshilluesi financiar mund të ndihmojë për të përcaktuar nëse kualifikoheni për ndihmë financiare. Këshilluesit financiarë mund të ofrojnë gjithashtu kopje falas të Politikës së Asistencës Financiare, Aplikimit dhe Përmbledhjes në Gjuhë të Thjeshtë.